

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVES – Departamenti per Krime te Renda, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro , kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunoren profesionale Rrezarta Lleshaj, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.S, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-se, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.S-av.Q.M, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.1075/13 të datës 08.03.2016 në seancën e Kolegjit të mbajtur konform nenit 390 par 1 të KPPRK - së, më datë 06 tetor. 2016 mori këtë :

AKTGJYKIM

- I) Me aprovimin e pjesërisht të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit B.S, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.1075/13 i datës 08.03.2016 NDRYSHOHET vetëm përkitazi me vendimin mbi denimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin B.S për veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-se, e gjykon me denim me burg në kohezgjatje prej 1(një) vjet e 6(gjashtë) muaj si dhe me denim me gjobe në shumë prej 2000(dy mijë) Euro, e të cilat denime do të ekzekutohen pas plotëfuqishmerisë së aktgjyqimit.
- II) Në pjesën tjetër-lidhur me obligimin për kërkesën pasurore-juridike, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.1075/16 të datës 08.03.2016 i akuzuari B.S nga Podujeva, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-se, për të cilën i është shqiptuar denimi me burgim në kohezgjatje prej 2(dy) viteve si dhe denimi me gjobe në shumë prej 3000(tremijë) Euro, cili denim do të ekzekutohet në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) dite pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kercenimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogaritës së fundimtare të gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50(pesëdhjetë) Euro e të gjitha këto në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotëfuqishmerisë së aktgjyqimit.

I akuzuari është obliguar që konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-se që pales së demtuar Postes së Kosovës në emër të demit të shkaktuar të i'a kompenzojë shumën prej

29.906,10 Euro ne afat prej 15(pesembedhjete) ditesh pasi qe aktgjykimi te mere formen e prere.

Kundër këtij aktgjykimi ne afatin ligjor ankesa ka paraqitur :

Mbrojtasi i te akuzuarit B.S,-av.Q.M nga Prishtina,per shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedures penale, vertetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, shkeljes se ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosoves aktgjykimin e atakuar te Gjykates Themelore ne Prishtine, ta ndryshoj dhe te akuzuarin konfrom nenit 398 par.1.4 te KPPRK-se ta liroj nga akuza ose aktgjykimin e gjykates se shkalles se pare ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne rigjykim dhe vendosje gjykates se shkalles se pare apo te njejtin ta ndryshoj perkitazi me cilesimin juridik te vepres,vendimit mbi denimin me burgim atij me gjobe si dhe kompenzimin e demit dhe te akuzuarin ta shpall fajtor per vepren penale perdorimi i paautorizuar i pasurise nga neni 427 te KPPRK-se.

Prokurori i Apelit i Kosoves, me shkresen e vet PPA/I.nr.410/16 te dates 12.08.2016 ka propozuar qe ankesa e mbrojtetit te akuzuarit B.S e ushtruar kunder aktgjykimit te Gjykates Themelore ne Prishtine te refuzohet si e pabazuar ndersa aktgjykimi i atakuar te vertetohet.

Gjykata e Apelit e Kosoves, mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 te KPPRK-es,ne te cilen prezentuan i akuzuari B.S,mbrojtasi i tij av.Q.M si dhe perfaqesuesi i te demtueses Telekom i Kosoves-N.R, ndersa nuk prezantoi Prokurori i Apelit edhe pse i njejti eshte njoftuar ne menyre te rregullt , andaj seanca u mbajt ne pajtim me nenin 390 par. 4 te KPPRK-se. I akuzuari si dhe mbrojtasi i tij mbeten prane pretendimeve ankimore duke propozuar qe te aprovohet ankesa dhe i njejti te lirohet nga akuza ose aktgjykimi i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet lidhur me cilesimin juridik me q'rast te akuzuarit do t'i shqiptohet nje denim me i ulet.

Perfaqesuesi i pales se demtuar-Telekomi i Kosoves-av.N.R, propozoi qe i akuzuari siq eshte obliguar me aktgjykim te gjykates se shkalles se pare te demtueses te i'a kompenzoj denim e shkaktuar prej 29.906,10 Euro.

Kolegji penal i Gjykates se Apelit te Kosoves, pasi shqyrtoi te gjitha shkresat e qeshtjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par. 1 të KPPRK-se dhe pas vleresimit te pretendimeve te cekura ne ankese dhe gjeti se :

- ankesa e mbrojtetit te akuzuarit B.S pjeserisht eshte e bazuar.

Perkitazi me bazen ankimore shkeljet esenciale te dispozitave te procedures penale te parapara nga neni 384 par.1 nenpar.1.7,1.9 dhe 1.12 lidhur me nenin 370 par.7 te KPP-se, mbrojtasi i te akuzuarit B.S thekson se dispozitivi i aktgjykimit te ankimuar eshte i pakuptueshem, kontradiktor me vetveten, dhe me arsyet e dhëna ne aktgjykim e veqanerisht me përmbajtjen e shkresave dhe provave te administruara gjate seancave gjyqesore e gjithashtu nuk jane dhene arsye mbi faktet vendimtare te kesaj qeshtje penale.Gjykata nuk ka paraqitur ne menyre te qarte dhe te plote faktet per te cilat ka konsideruar se jane vertetuar

pertej dyshimit te bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale per te cilen eshte shpallur fajtor dhe gjykuar, e gjithashtu sipas mbrojtjesit te akuzuarit gjykata nuk i ka vertetuar provat kunderthenese dhe nuk i ka arsyetuar deshmite dhe pse disa provave ja ka fale besimin e disa provave jo.

Sipas mbrojtjesit te akuzuarit , i akuzuari nuk e ka marre-perdorur shumen prej 29.906,10 euro por vetëm ate prej 16,540,30 euro te cilën shume i akuzuari qe nga fillimi i procedurës nuk e kishte mohuar por te njëjtën shume e ka mare per tu shërbyer përkohësisht ,per shërimin e vajzës tij te mitur nga boshti kurrizor ne Turqi e te cilën shume e ka konstatuar edhe komisioni i kontrollit te gjendjes se arkës.

Gjykata e Apelit e Kosoves gjeti se pretendimet e mesiperme ankimore nuk qendrojne ngase aktgjykimi i ankimuar nuk permban shkelje esenciale te dispozitave te procedures penale te pretenduara me ankese e as shkelje te tjera esenciale te dispozitave te procedurës penale te cilat kjo gjykate i konstaton sipas detyres zyrtare e te cilat kishin me kushtezuar anulimin e tij.

Dispozitivi i aktgjykimit te ankimuar eshte i qarte, konkret, nuk permban kunderthenie qofte me vetveten, qofte ne arsyetimin e tij. Ne arsyetimin e aktgjykimit te ankimuar jane dhene arsye te duhura faktike dhe juridike, te cilat i aprovon edhe kjo gjykate duke vene ne dukje se cilat fakte dhe per qfar arsyes i mere si te provuara ose si te paprovuara, duke bere vleresimin e provave kontradiktore konform nenit 370 te KPPRK-se. Gjykata e shkalles se pare ka bere vleresimin dhe analizen e te gjitha provave te administruara gjate shqyrtimit gjyqësor duke i paraqitur lidhur me to pretendimet e veta te cilat si te drejta dhe te ligjshme i aprovon edhe kjo gjykate.

Sa i perket pretendimeve ankimore te mbrojtjesit te akuzuarit lidhur me vertetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike i njejti pretendon se gjykata e shkalles se pare gabimisht dhe ne menyre jo te plote e ka vertetuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se i akuzuari B.S, ka kryer veprën penale përvetësimi ne detyre nga neni 425 par 2 lidhur me par 1 te KPRK-se, duke u bazuar ne raportin e analizës financiare te dt.30.10.2013 me te cilin eshte konstatuar mungesa e gjetjes ne arke shuma prej 29.906,10 euro, ku i akuzuari ka punuar si kontrollor i zyrës postare ne ... –PK SH.A. ne piken postare ne ..., ndërsa nuk e ka patur parasyshe komisioni i kontrollit te gjendjes se arkës dy here radhazi e ka konstatuar mungesën prej 16.540,30 euro, dhe se shuma e mungese se parave prej 29.906,10 euro nuk eshte reale..

Gjykata e Apelit e Kosoves gjeti se pretendimet ankimore lidhur me vertetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike nuk janë te bazuara ngase prova e administruar – raporti i mungesës i përpiluar nga koordinatorja e financave te postes te datës 27.06.2013 eshte vërtetuar se me sa produkte dhe mjete ka qene i ngarkuar dhe mungesat ne raportet e arkës ne posten numër .. ku eshte gjetur mungesa prej 29.906,10 euro e kjo gjendje eshte vërtetuar edhe me ekspertizën e kryer nga ana e ekspertit financiar R.B, te datës 08.10.2015. e te cilën e ka arsyetuar edhe ne shqyrtimin gjyqësor..

Pra, nga kjo del se Gjykata e shkalles se pare drejte dhe ne menyre te plote e ka vertetuar gjendjen faktike e nga kjo del se ne rastin konkret gjykata e shkalles se pare drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal kur te akuzuarin e ka shpallur fajtor per veprën penale

përvetësimi ne detyre nga neni 425 par.2 lidhur me par 1 te KPRK, andaj gjeti se edhe pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal ne dëme te akuzuarit nuk janë te bazuara.

Duke vlerësuar pretendimet ankimore te mbrojtësit te akuzuarit lidhur me sanksionin penal se gjykata e shkalles se pare nuk i ka vlerësuar sa duhet rrethanat lehtesuese ,Gjykata e Apelit e Kosoves gjen se këto pretendime janë pjesërisht te bazuara.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartesine e denimit gjykata e shkalles se pare drejte i ka vlerësuar rrethanat lehtesuese dhe renduese ne kuptim te nenit 73 e te cilat mund te ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, ku si rrethane lehtesuese per te akuzuarin B.S ka marre parasysh se i njejti eshte i martuar, baba i dy femijeve, i papune kurse si rrethane renduese mori faktin se ky lloj i veprave penale eshte ne rritje ne territorin e Kosoves. Gjykata e Apelit me rastin e vlersimit te pretendimeve ankimore lidhur me dënimin gjeti se edhe me nje dënim te shqiptuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 te KPRK-es dhe se rretana renduese e mare nga ana e gjykatës Themelore se këto vepra penale janë ne rritje nuk mund te meret si rrethane renduese ngase kemi te bëjmë ne qdo rast me përgjegjësini penale individuale per veprën penale te kryer .

Sa i përket pretendimit ankomor lidhur me kompenzimin e demit palës se dëmtuar ,Gjykata e Apelit gjeti se nuk eshte i bazuar ngase me te njëjtin aktgjykim sakte eshte vërtetuar demi i shkaktuar dhe ne kete pjese aktgjykimi u vërtetua.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 dhe 403 të Kodit te Procedures Penale të Kosovës u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË,
PAKR.nr.441/16 te dates 06.10.2016**

**Procesmbajtesja:
Rrezarta Lleshaj**

**Anëtarët e kolegjit,
Abdullah Ahmeti**

**Kryetari i kolegjit.
Fillim Skoro**

Xhevdet Abazi